



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 1469 Prot.

Tiranë, më 05.05.2026

VENDIM

Nr. 72, Datë 21.04.2026

**“PËR TRANSFERIMIN E PROKURORIT LEDION TEMA NË PROKURORINË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM ELBASAN, NËPËRMJET PROCEDURËS SË LËVIZJES
PARALELE”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar (në mungesë)
8. Vatë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 21.04.2026, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për transferimin e prokurorit Ledion Tema në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 1469, dt. 09.04.2026, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, pasi dëgjoi Relatorin, znj. Ledina Riza si dhe diskutimet e zhvilluara në mbledhje plenare mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë *(në vijim Këshilli)* është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me Vendimin nr. 13, datë 16.02.2024, *“Për shpalljen e 18 (tetëmbëdhjetë) vendeve vakante për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”*, Këshilli ka shpallur 18 (tetëmbëdhjetë) vende vakante në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Elbasan, Lezhë, Sarandë, Kukës, Korçë, Tiranë dhe Vlorë, të cilat do të plotësoheshin nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

Njëri ndër vendet e shpallura është pozicioni vakant nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
3. Njoftimi me të dhënat lidhur me subjektet që kanë të drejtë të kandidojnë, kushtet ligjore, afati deri kur pranohen aplikimet, etj., është publikuar në faqen zyrtare të Këshillit më datë 20.02.2024.
4. Pas përfundimit të afatit të aplikimit në datë 06.03.2024, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës¹ filloi punën me verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve që kanë aplikuar për këtë pozicion, që është edhe *faza e parë* e procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele. Në përfundim të këtij procesi, Komisioni i propozoi Këshillit miratimin e listës së kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet ligjore të kandidimit.
5. Bazuar në nenin 43, pika 6, të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*², i ndryshuar, dhe nenin 15, të Rregullores *“Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”*³, me Vendimin nr. 37, datë 28.03.2024, *“Për fillimin e verifikimit të kandidatëve për plotësimin e kushteve ligjore të kandidimit për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, të shpallur me Vendimin nr. 13, datë 16.02.2024, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”*, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që u kualifikuan për të vijuar garën.
6. Në po të njëjtin vendim, Këshilli vendosi caktimin me short të relatorit për secilin nga pozicionet e shpallura ku, për pozicionin vakant nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan u zgjodh si relator, anëtarja e Komisionit, znj. Ledina Riza.
7. Në zbatim të nenit 11, pikat 1 dhe 2, të Rregullores, kandidatët e kualifikuar për këtë pozicion janë njoftuar nga ana e relatores për fillimin e procedurës së vlerësimit të

¹ Në vijim, Komisioni

² Në vijim, Ligji për Statusin

³ Në vijim, Rregullorja

kandidatëve, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo ndonjë anëtarit të Këshillit, në rast të ekzistencës së një shkakut të konfliktit të interesit. Në vijim rezultoi se, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e relatorit apo ndonjë anëtarit të Këshillit.

8. Bazuar në nenet 9, germa “b”, 16, 17, 19 dhe 41, të Rregullores është vijuar me *fazën e dytë* të procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, me renditjen e kandidatëve dhe verifikimin e kriterëve përkatëse.

9. Për pozicionin vakant nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan kanë aplikuar kandidatët⁴, si më poshtë:

- i. Albjona Papajani - prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;
- ii. Alisa Spahja – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
- iii. Besmira Vishe - prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
- iv. Blerina Musabelliu - prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;
- v. Denis Hyka - prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lushnjë;
- vi. Eni Çulli – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;
- vii. Erida Visoçi – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;
- viii. Ermira Manelli - prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
- ix. Esmeranda Basho, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;
- x. Gjergji Ceka – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
- xi. Ledion Tema, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
- xii. Marsida Frashëri – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
- xiii. Odeta Todorushi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Korçë;
- xiv. Xhoana Mehmetaj - prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

10. Në vijim, kandidatët Albjona Papajani, Alisa Spahja, Besmira Vishe, Blerina Musabelliu, Denis Hyka, Eni Çulli, Erida Visoçi, Ermira Manelli, Gjergji Ceka, Odeta Todorushi dhe Xhoana Mehmetaj kanë paraqitur kërkesë për tërheqje nga gara, kërkesa të cilat janë administruar në Këshill, si vijon:

⁴ Sipas rendit alfabetik

- i. Albjona Papajani – Kërkesë me nr. 827/1, datë 07.03.2025 ex.;
- ii. Alisa Spahja – Kërkesë me nr. 598/1prot., datë 12.05.2025;
- iii. Besmira Vishe – Kërkesë me nr 652/1, datë 12.05.2025;
- iv. Blerina Musabelliu – Kërkesë me nr. 651/1 prot., datë 12.05.2025;
- v. Denis Hyka – Kërkesë nr. 794/2, datë 06.03.2025 ex.;
- vi. Eni Çulli – Kërkesë nr. 834/1, datë 07.03.2025 ex.;
- vii. Erida Visoçi – Kërkesë nr. 840/1, datë 07.03.2025 ex.;
- viii. Ermira Manelli – Kërkesë nr. 842/2, datë 06.03.2025;
- ix. Gjergji Ceka – Kërkesë nr. 807/2 ex., datë 06.03.2025;
- x. Odeta Todorushi - Kërkesë me nr. 821/1, datë 26.06.2024;
- xi. Xhoana Mehmetaj – Kërkesë nr. 645, datë 07.03.2025.

11. Vazhdimi i mëtejshëm i garës për këtë lëvizje paralele për kandidaten tjetër Marsida Frashëri është ndërprerë pasi, me Vendimin nr. 46/2025, datë 10.06.2025, Kolegji i Posaçëm i Apelimit⁵ ka vendosur ndryshimin e Vendimit nr. 696, datë 11.09.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra.

12. Për sa më sipër, për pozicionin vakant nr. 2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, kandidatët që vazhduan procesin e verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore të renditjes janë:

- i. Esmeranda Basho
- ii. Ledion Tema

13. Sa i renditjes së kandidatëve në procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, në nenin 43, pikat 7 dhe 8, të Ligjit për Statusin, parashikohet se:

“7. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin magistratët që përmbushin kërkesat, sipas rezultateve të mëposhtme:

a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke përfshirë edhe ato si magistrat i komanduar, duke pasur parasysh:

b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës “a”, të pikës 7, të këtij neni, ka më shumë se një magistrat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta magistratë sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë;

c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës “b”, të pikës 7, të këtij neni, ka më shumë se një magistrat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta magistratë sipas vjetërsisë si magistrat.

8. Në rastet e lëvizjes paralele në gjykatë ose prokurori të shkallës së parë, kur nuk ka kandidime, sipas pikës 7, të këtij neni, procedura e lëvizjes paralele hapet për magistratët, të cilët nuk janë vlerësuar dy herë. Ata renditen duke u bazuar njëkohësisht:

- a) në rezultatit e vlerësimit etik dhe profesional përkatës;*
- b) në renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magistratit të riemëruar sipas nenit 36 të këtij ligji.”*

14. Ndërsa, në nenet 9, pika 1, germa “b” dhe 17, pika 2, të Rregullores, parashikohet se:

⁵ <https://kpa.al/njoftim-vendimi-331/>

Neni 9
Fazat e procedurës së lëvizjes paralele

1. Procedura e lëvizjes paralele zhvillohet në tre faza, si më poshtë:

- a) në fazën e parë bëhet verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kushteve ligjore të kandidimit;
- b) në fazën e dytë bëhet renditja e kandidatëve të kualifikuar sipas numrit të vlerësimeve etike dhe profesionale. Konkretisht:
 - i. fillimisht shqyrtohen kandidimet e prokurorëve, të cilët kanë dy vlerësime etike dhe profesionale;
 - ii. Nëse nuk ka kandidime nga prokurorë me dy vlerësime etike dhe profesionale, atëherë shqyrtohen kandidimet e prokurorëve të cilët kanë një vlerësim etik dhe profesional;
 - iii. Nëse nuk ka as kandidime nga prokurorë me një vlerësim etik dhe profesional, atëherë shqyrtohen kandidimet e prokurorëve, të cilët nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional;
- c) në fazën e tretë merret vendimi për transferimin e kandidatit të renditur më lart.

Neni 17
Radha e shqyrtimit të kandidaturave

- 1. Procedura e lëvizjes paralele për një pozicion të lirë fillimisht vazhdon për kandidatët që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale.
- 2. Në rastin kur për pozicionin e lirë nuk ka kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale, ose kur kandidatët e kësaj kategorie janë tërhequr nga kandidimi, ose kur ata nuk janë kualifikuar për mosplotësim të kriterëve të kandidimit, procedura e lëvizjes paralele vazhdon për kandidatët që kanë apo mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional.
- 3. Nëse për arsyet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, procedura e lëvizjes paralele nuk mund të vazhdojë për kandidatin me një vlerësim etik dhe profesional, atëherë ajo vazhdon për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional.
- 4. Nëse për të njëjtat arsye, procedura e lëvizjes paralele nuk mund të vazhdojë edhe për kandidatët pa asnjë vlerësim etik dhe profesional, atëherë ajo konsiderohet e përfunduar dhe pozicioni rishpallet përsëri.

15. Pas verifikimeve në të dhënat e dosjeve personale të kandidatëve të kualifikuar, në zbatim të nenit 43, pikat 7 dhe 8, të Ligjit për Statusin dhe neneve 17, pika 2, 32 dhe 33, pika 1 dhe nenin 41, të Rregullores, lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale të kandidatëve ka rezultuar se:

- i. Kandidatja Esmeranda Basho nuk ka asnjë vlerësim etik dhe profesional.
- ii. Kandidati Ledion Tema ka një vlerësim etik dhe profesional dhe është vlerësuar me nivelin “Shkëlqyeshëm”.

16. Bazuar në kriterin ligjor të pasjes së një vlerësimi etik dhe profesional, nga kandidatët e mësipërm vetëm magjistrati Ledion Tema ka 1 (një) vlerësim etik dhe profesional, si vijon:

Nr.	Kandidati	Viti i vlerësimit etik dhe profesional	Niveli i vlerësimit
1.	Ledion Tema	Viti 2023	Shkëlqyeshëm

17. Rezulton se me Kërkesën datë 16.04.2026 (regjistruar me nr. 1661, datë 16.04.2026), drejtuar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, kandidatja Esmeranda Basho ka deklaruar heqjen dorë nga aplikimi për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin vakant nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me Vendimin nr. 13, datë 16.02.2024, të Këshillit.
18. Për rrjedhojë, kandidati Ledion Tema renditet i pari dhe i vetmi për pozicionin vakant nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, i cili ka 1 (një) vlerësim etik dhe profesional.
19. Bazuar në sa më sipër, u vlerësua se duhet të procedohet edhe me transferimin e kandidatit i cili ka konkurrar për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele, për pozicionin vakant nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
20. Në këtë rast gjen zbatim parashikimi i nenit 18, të Kodit të Procedurave Administrative, titulluar "Parimi i deburokratizimit dhe efijensës", i cili në pikën 2, të tij, parashikon se: *"2. Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm"*.
- Referuar përmbajtjes së kësaj dispozite, rezulton se aplikimi i këtij parimi kërkon që të plotësohen kumulativisht këto kushte:
- procedura të zhvillohet sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të;
 - me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët;
 - në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm.
21. Duke patur parasysh se, kandidati Ledion Tema është i pari dhe i vetmi kandidat që vijon të garojë në këtë procedurë të lëvizjes paralele dhe se nuk ka kandidatë të tjerë që mund të ankohen brenda afatit ligjor në rrugë gjyqësore ndaj vendimit për renditjen e tij, pas renditjes së mësipërme në përputhje me nenin 43, pika 9, të Ligjit për Statusin dhe nenet 17, pika 3, të Rregullores, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozoi Këshillit edhe transferimin e kandidatit Ledion Tema në pozicionin vakant nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me Vendimin nr. 13, datë 16.02.2024, të Këshillit.
22. Sa i takon hyrjes në fuqi të aktit dhe krijimit të pasojave, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë në kushtet kur, para faktit të sigurimit të një kalimi të detyrës

në mënyrë graduale, Komisioni iu referuar nenit 104, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet se:

“1. Një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve.

2. Akti administrativ i miratuar në heshnje fillon të sjellë pasoja juridike, në ditën e përfundimit të afatit për njoftimin e tij, sipas nenit 97 të këtij Kodi.

3. Një akt administrativ mund të fillojë të sjellë pasoja juridike në një datë tjetër, të caktuar shprehimisht nga vetë akti, por në asnjë rast përpara njoftimit të palës, sipas pikës 1 të këtij neni. Në këtë rast, data e fillimit të pasojave juridike caktohet shprehimisht në pjesën e dispozitivit të aktit administrativ të shkruar.

4. Një akt administrativ sjell pasoja juridike:

a) për sa kohë nuk është anuluar apo shfuqizuar, kryesisht apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore administrative ose gjyqësore;

b) për sa kohë nuk ka përfunduar afati i aktit ose nuk është përmbushur qëllimi i tij; ose

c) për çfarëdo arsyeje tjetër të parashikuar nga ligji.”

23. Referuar sa më sipër, pasojat juridike të aktit administrativ dhe fillimi i ushtrimit të detyrës efektive në zyrën e prokurorisë pritëse, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të Prokurorisë, do të krijohen në një moment të dytë, konkretisht në datë 04.05.2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 42 dhe 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 104, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 45, të Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”, e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Transferimin e prokurorit Ledion Tema në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nëpërmjet lëvizjes paralele.
2. Marrëdhëniet financiare që lidhen me pagën dhe përfitimet e tjera do të përballohen nga Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan duke filluar nga data 04.05.2026.
3. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Ledion Tema, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 21.04.2026.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË


KRYETAR
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla